



**BANKA E SHQIPËRISE**  
Governatori

**KONFERENCE PER SHTYP E GUVERNATORIT TE BANKES  
SE SHQIPERISE, Z.SHKELQIM CANI**

**ARRITJET E BANKES SE SHQIPERISE  
GJATE VITIT 2003 DHE  
PARASHIKIMET PER VITIN 2004**

**TIRANE, 06 SHKURT 2004  
ORA 10.30**

# ARRITJET E BANKES SE SHQIPERISE GJATE VITIT 2003 DHE PARASHIKIMET PER VITIN 2004

## I. Zhvillimet kryesore 2003 dhe parashikimet-2004

### I. 1. Përmbledhje e arritjeve kryesore të Bankës së Shqipërisë dhe sistemit bankar gjatë vitit 2003.

Me kënaqësi vë re se viti 2003 shënoi një hop tjetër pozitiv për Bankën e Shqipërisë në drejtim të plotësimit të angazhimeve të saj ligjore, mbajtjes së objektivit të inflacionit, zhvillimit të sistemit bankar, rritjes së rezervës valutore, kursit kryesisht të sbatilizuar të këmbimit, imazhit publik etj.

Objektivi i Bankës së Shqipërisë për një nivel inflacioni vjetor në intervalin 2-4 për qind për vitin 2003 rezultoi i realizuar. Norma vjetore e inflacionit në muajin dhjetor me gjithë zhvillimet "suprizë" të rritjes së tarifave të telefonisë rezultoi 3.3 për qind ndërsa norma mesatare e inflacionit për vitin 2003 ishte 2.37 për qind.

Banka e Shqipërisë zhvilloi me sukses fushatën për parandalimin e rritjes spekulative të çmimeve në prag të festave të fundvitit. Konkluzionet e fushatës u prezantuan para pak ditësh dhe Banka e Shqipërisë falenderon mediat për bashkëpunimin dhe mbështetjen gjatë gjithë fushatës.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2003 ka patur tendenca të qarta zbutëse pasi norma bazë e interesit u ul me 2 pikë për qindje me katër vendime të Këshillit Mbikëqyrës. Ky veprim nuk ka ndikuar negativisht në treguesit monetarë të cilët kanë ecur sipas parashikimeve të programit monetar. Banka e Shqipërisë ka respektuar objektivat sasiorë, që janë edhe detyrimi i saj ligjor, si në nivelet e rezervës ndërkombëtare neto, mjeteve të brendshme neto dhe kredisë së brendshme neto për qeverinë.

Sistemi bankar gjatë vitit 2003 shënoi zhvillime pozitive në drejtim të mbështetjes së zhvillimit ekonomik të vendit me kredi dhe infrastrukturë bankare, sidomos në drejtim të shtimit të degëve dhe larmisë së shërbimeve.

Por, domethënëse për vitin 2003 ishte privatizimi i Bankës së Kursimeve nga banka e njohur austriake Raiffeisen Bank. Banka e Shqipërisë e shikon suksesin e këtij procesi jo vetëm te emri i mirë i bankës dhe premisat për zhvillimin e pritsëm të konkurrencës, kreditimit

dhe vetë sistemit bankar, por edhe te besimi i rritur i publikut te sistemi bankar.

Viti 2003 ka qenë një vit me zhvillime pozitive edhe në procesin e administrimit të rezervës valutore. Nga 839.6 milionë dollarë që ishte rezerva valutore në fillim të janarit, më 31 dhjetor 2003 ajo arriti në 1 miliardë e 25.6 milionë dollarë. Banka e Shqipërisë, gjatë 2-3 viteve të fundit u fokusua drejt rritjes së gamës së instrumentave të përdorur, strukturës së vendimmarrjes dhe strategjive të investimit. Pas këtij procesi, gjatë vitit 2003 jemi fokusuar në metodikën e zgjedhjes dhe ndërtimit të benchmarkëve(referencave), matjen e rezultateve të investimit kundrejt riskut drejt objektivit final të identifikimit të faktorëve që kontribuojnë në performancë.

Si pozitive, Banka e Shqipërisë vlerëson edhe zhvillimet në drejtim të procesit shkencor, zhvillimit të sistemit të pagesave, fushatave ndërgjegjësuese, publikimeve, bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare dhe aktorët e brendshëm institucionalë, akademikë, shoqërisë civile dhe medias.

## **I.2. Zhvillimet e pritshme për vitin 2004.**

Banka e Shqipërisë është angazhuar vazhdimisht në shpjegimin në publik, se ç'kupton ajo me stabilitet çmimesh dhe si do të punojë për arritjen e tij. Të arrish stabilitetin e çmimeve do të thotë të arrish norma të ulëta pozitive të inflacionit ose të ndryshimit të çmimeve të konsumit. Të ruash stabilitetin e çmimeve do të thotë të sigurosh norma të ulëta pozitive inflacioni për periudha relativisht të gjata kohe.

Banka e Shqipërisë ka përcaktuar në strategjinë e saj trevjeçare, "Plani i zhvillimit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë (2003 - 2005)", objektivin e inflacionit për këtë periudhë. Objektivi strategjik afatmesëm i politikës monetare është mbajtja e inflacionit në nivele të ulëta pozitive të cilat sigurojnë qëndrueshmëri në tregje dhe mbështesin rritjen ekonomike. Për periudhën afatmesme të mbuluar nga kjo strategji, Banka e Shqipërisë është e angazhuar në mbajtjen e inflacionit vjetor në nivelin rreth 3 për qind. Në zbatim të kësaj, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ruajë objektivin e inflacionit në formën e një bande, në intervalin 2 - 4 për qind për vitin 2004. Si objektivi i inflacionit vlerësohet rritja vjetore e indeksit të çmimeve të konsumit, matur dhe publikuar nga INSTAT.

Në funksion të këtij objektivi, programi monetar synon kontrollin e rritjes së ofertës monetare në mënyrë që niveli i mjeteve monetare reale t'i përgjigjet nevojave reale të ekonomisë për një rritje ekonomike prej 6 për qind. Parashikimi i kërkesës së ekonomisë vazhdon të mbështetet

në parashikimin e shpejtësisë thuhet konstante të qarkullimit të parasë. Ky parashikim, duke u nisur nga niveli i PBB-së nominale, është pika lidhëse midis inflacionit dhe rritjes së ofertës monetare (objektivi i ndërmjetëm).

Programi monetar garanton respektimin e objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë, mbajtjen e nivelit të MBN dhe RNN të Bankës së Shqipërisë brenda kufijve dhe kontrollin e huamarrjes së brendshme të qeverisë në nivelin 2.8 për qind të PBB-së.

Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare i vërejtur gjatë vitit 2003 nuk pritet të pësojë ndryshime thelbësore gjatë vitit të ardhshëm. Ndërkohë që parashikohet një tendencë në rritje e raportit të depozitave në valutë ndaj M3, duke sjellë një rënie e peshës së depozitave në lekë ndaj ofertës monetare. Depozitat në valutë pritet të kenë një rritje të konsiderueshme vjetore, prej rreth 18.2 përqind, ose 17.7 miliardë lekë, në fund të vitit 2004.

Sistemi bankar parashikohet të plotësojë totalisht nevojat e sektorit privat për kredi në lekë si dhe kërkesën e qeverisë për financimin e deficitit. Banka e Shqipërisë mund të financojë deri në 5 përqind të mesatares së të ardhurave të qeverisë në tre vitet e fundit, ose rreth 7.5 miliardë lekë. Në këtë mënyrë, huamarrja ose investimi i fondeve të lira të bankave të nivelit të dytë në Bankën e Shqipërisë do të shërbejë për zbutjen e efekteve të disbalancimit të kërkesës dhe ofertës për mjete monetare të brendshme në ecurinë e likuiditetit gjatë vitit.

## **II. Ekonomia shqiptare gjatë vitit 2003 në këndvështrimin e Bankës së Shqipërisë.**

Viti 2003, parë në kompleksitetin e tij, për Bankën e Shqipërisë dhe për ekonominë shqiptare, mund të konsiderohet një vit i mbarë. Gjykimin tonë në këtë vlerësim, e mbështesim në treguesit e përmirësuar makroekonomikë, në krahasim me një vit më parë. Ndonëse kuadri i shifrave nuk mbulon tërësisht vitin 2003 dhe ndoshta për disa sektorë të ekonomisë, disponohen vetëm vlerësime të tërthorta, zhvillimet e deritanishme në ekonomi, janë mëse shpresëdhënëse për arritjen e parashikimit të rritjes ekonomike prej 6 për qind, kundrejt një rritjeje 4.7 për qind të faktuar në vitin 2002. Për më tepër, parashikohet një rritje në të gjithë sektorët e ekonomisë, por më e theksuar ajo duket të jetë në sektorin e ndërtimit dhe të shërbimeve.

Tabelë: Rritja reale e parashikuar e sektorëve të ekonomisë për vitet 2002-2003 (në %).

Sektorët	2002	2003
<b>Rritja reale e PBB</b>	4.7	6.0
Industria	1.8	2.7
Bujqësia <sup>1</sup>	2.1	3.0
Ndërtimi	8.7	11.3
Transporti	9.7	10.8
Shërbimet	5.1	6.4

Burimi: Ministria e Financave.

Tabelë : Përbërja e sektorëve në PBB (në përqindje).

	2002	2003
Bujqësia	25.4	24.7
Industria	10.5	10.2
Ndërtimi	8.6	9.1
Transporti	9.6	10
Shërbimet	45.9	46.1

Burimi: Ministria e Financave.

Drejtime të tjera që dëshmojnë për konsolidim të mjetejshëm makroekonomik janë: respektimi i objektivit të inflacionit gjatë vitit 2003; ruajtja e deficitit buxhetor brenda kufijve të programuar; ruajtja e një pozicioni të favorshëm të bilancit të pagesave, e shprehur kjo me rritjen e rezervës valutore.

## **II.1. Disa zhvillime për degë të ndryshme të ekonomisë:**

**Bujqësia**, mbetet një nga mbështetëset e ritmeve të rritjes, për sa kohë që kontributi i saj në PBB, është ende i konsiderueshëm. Sipas vlerësimeve më të fundit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, është parashikuar që rritja e prodhimit në sektorin e bujqësisë të jetë rreth 4.1 për qind (së bashku me agroindustrinë dhe peshkimin).

Duket se ritmet e rritjes më të mira të bujqësisë për vitin 2003, i atribuohen më së shumti një prodhimi më të lartë blegtoral dhe frutor. Megjithatë, gjykohet se prodhimi bujqësor, është çënuar disi edhe nga kushtet e motit, të pafavorshme, (temperaturat e ulta të muajit prill dhe temperaturat e larta të muajit qershor), kushte të cilat shkaktuan dëmtime të bimëve bujqësore, kryesisht të drithërave (grurë dhe misër).

**Sektorë të ndryshëm të ekonomisë**, kanë demonstruar ritme të kënaqshme rritjeje gjatë nëntëmujorit të vitit 2003 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shifrat pozitive të tabelës, flasin për një lloj rritjeje të aktivitetit ekonomik në **industri, në transport** dhe

<sup>1</sup> Këtu përfshihet vetëm sektori i bujqësisë dhe blegtorisë, pa degën e agroindustrisë dhe peshkimit.

**telekomunikacion,** duke spikatur **ndërtimi,** si një nga sektorët e rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. Në këtë sektor, treguesi i shitjeve, paraqet ecuri në rritje të vijueshme, ku tremujori i tretë i vitit 2003 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ka regjistruar shifrën më të lartë gjatë tremujorëve, afër 23 për qind. Megjithatë, çmimet në këtë sektor ende vijojnë të rriten, si nga njëri tremujor në tjetrin, ashtu edhe nga njëri vit në tjetrin. Kjo tregon se kërkesa e lartë në mënyrë të vazhdueshme po ushtron efektin e saj mbi çmimet në ndërtim, ku padyshim një ndikim të veçantë mund të ketë edhe mbiçmimi i dukshëm i euros ndaj monedhës vendase.

Tendenca e ndërtuesve për të tregtuar produktet e tyre në monedhën evropiane, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ka ndikuar rritjen e çmimeve të konvertuara në lekë, në këtë sektor. Vetëm në tremujorin e tretë të vitit 2003 indeksi i kushtimit në ndërtim shënoi një rritje prej afër 3.47 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

**Energjitika,** është sektori që ka shënuar rritje në disa tregues gjatë vitit 2003. Në veçanti, tremujori i tretë i këtij viti, ka reflektuar përmirësime të ndjeshme duke shënuar rritje të ndjeshme të prodhimit në vend. Ky fakt ka bërë që importet të ulen në 32 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Po kështu, prodhimi i brendshëm ka plotësuar rreth 63 për qind të kërkesës së brendshme përdoruese në krahasim me 46 për qind që plotësoi një vit më parë.

**Tregues te ndryshëm të kërkesës së brendshme,** si ai i konsumit të karburanteve, importit të autovecurave dhe të pajisjeve elektroshtëpiake, për periudhën janar-shtator 2003, kanë pësuar rritje të dukshme në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Investimet,** gjatë vitit 2003 nuk kanë paraqitur ndonjë zhvillim pozitiv të spikatur. Ndërsa investimet e huaja direkte paraqiten në rritje, shpenzimet kapitale të buxhetit të shtetit janë realizuar në një nivel jo të kënaqshëm. Niveli i tyre gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2003 është rritur me 4.5 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2002. Gjatë njëmbëdhjetë muajve të parë të vitit, shpenzimet kapitale janë realizuar vetëm në masën 60 për qind të nivelit të parashikuar. Mbi 60 për qind e shpenzimeve kapitale gjatë vitit 2003 janë financuar nga burimet e brendshme.

**Aktiviteti i tregtisë së jashtme,** gjatë periudhës janar-shtator 2003 volumi i tregtisë është rritur ndjeshëm në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Për më tepër kjo është një rritje e verifikuar si nga krahu i importeve ashtu edhe nga ai i eksporteve, respektivisht me afro 10 dhe 22 për qind. Megjithë këtë rritje të ndjeshme të eksporteve, pësha e tyre mbetet ende e ulët në vëllimin e përgjithshëm të tregtisë së

jashtme. Janë rieksporet që duke mbajtur peshën kryesore të eksporteve shqiptare, japin efektin më të lartë në rritjen e këtyre të fundit.

## **II. 2. Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë.**

Deficiti i llogarisë korrente në periudhën janar-shtator 2003 rezultoi 258 milionë usd ose 14 përqind më i ulët se ai i së njëjtës periudhe të vitit të kaluar. Kjo periudhë karakterizohet nga shpenzime dhe të ardhura korrente më të larta. Totali i transaksioneve korrente ishte 3.5 miliardë usd, nga të cilat 1.9 miliardë usd, ishin shpenzime dhe 1.6 miliardë usd të ardhura. Afërsisht 67 përqind e shpenzimeve korrente ishin pagesa importi të cilat kapën shifrën 1.3 miliardë usd, ndërsa dy grupet më të mëdha të të ardhurave ishin shërbimet dhe transfertat korrente, të cilat shënojnë respektivisht 518 milionë usd dhe 651 milionë usd. Rreth 75 përqind e deficitit të llogarisë korrente u financua nga hyrjet neto të llogarisë kapitale dhe financiare, të cilat u vlerësuan 193 milionë usd.

**Tabelë : Zërat e bilancit të pagesave (janar – shtator 2003).**

### **Bilanci i Pagesave**

në milionë dollarë amerikanë

	9m-I 2002	3m-I 2003	3m-II 2003	3m-III 2003	9m-I 2003
Llogaria Korente	-299.7	-31.6	-119.4	-106.6	-257.6
Eksporti i mallrave	234.2	108.6	113.7	102.0	324.3
Importi i mallrave	-1059.1	-394.1	-453.8	-434.0	-1281.9
Bilanci Tregtar	-824.8	-285.5	-340.1	-332.0	-957.6
Shërbimet: Kredi	408.8	128.1	177.8	212.0	517.9
Shërbimet: Debi	-443.0	-119.1	-185.4	-242.2	-546.7
Të Ardhurat: Kredi	113.2	44.0	49.2	56.8	150.0
Të Ardhurat: Debi	-16.5	-5.1	-6.8	-4.9	-16.8
Transferta Private Pashpërblim	433.1	198.2	177.8	189.8	565.8
Transferta Shtetërore Pashpërblim	29.5	7.9	8.1	14.0	29.9
Llogaria Kapitale	87.1	31.0	36.5	45.7	113.1
Llogaria Financiare	174.8	40.7	30.3	8.5	79.6
Investime Direkte	94.1	27.0	36.9	34.4	98.3
Investime Portofoli	-32.8	-11.4	6.8	-14.0	-18.5
Kapitale të Tjera*	108.3	19.6	-13.4	-17.5	-11.3
Gabime dhe Haresa Neto	74.5	16.9	56.8	69.7	143.3
<b>Bilanci i Përgjithshëm</b>	<b>36.7</b>	<b>57.0</b>	<b>4.2</b>	<b>17.2</b>	<b>78.5</b>
Rezervat dhe Zëra të Lidhur me to.					
Mjetet e Rezervës	-36.7	-57.0	-4.2	-17.2	-78.5
Përdorim Huash e Kredish nga FMN	5.3	5.5	0.0	5.6	11.1
Për t'u Mbajtur në Vëmendje					
Ndryshimi Total në Rezerva	-76.5	-61.0	-32.7	-19.7	-113.4
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	39.2	12.5	22.1	12.3	46.9


\*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN

## **II.3. Zhvillimet në sektorin fiskal**

Treguesit fiskalë kanë ecur përgjithësisht në nivele më të ulta se parashikimet, gjatë periudhës janar- nëntor 2003. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, deri në fund të muajit nëntor, janë mbledhur 93


për qind e të ardhurave totale të parashikuara dhe janë realizuar rreth 88 për qind e shpenzimeve të programuara për këtë periudhë. Mosrealizimi i shpenzimeve të planifikuara ka bërë që deficitin buxhetor, në fund të muajit nëntor, të jetë rreth 27 miliardë lekë nga 40.4 miliardë lekë të parashikuar. Financimi i brendshëm i deficitit me bono thesari ka respektuar objektivin e vënë në fillim të vitit. Ndërsa financimi i huaj i deficitit arriti në 7.7 miliardë lekë ose 32 për qind të vlerës së parashikuar.

**Grafik : Treguesit vjetorë fiskalë, në vitet 1990-2003 (si për qindje ndaj PBB-së).**



\* Të dhënat për vitin 2003 janë të parashikuara për fund-vitin

**Grafik:Financimi i deficitit buxhetor që prej janarit të vitit 1998.**



### III. Zhvillimet e inflacionit dhe Politika Monetare.


#### III.1. INFLACIONI.

Ecuria e çmimeve të konsumit, kufizimi i luhatjeve të të cilave përbën edhe objektivin kryesor të Bankës së Shqipërisë, ka qenë e favorshme gjatë vitit 2003. Me zhvillim të favorshëm, kam parasysh respektimin e vazhdueshëm të objektivit të Bankës së Shqipërisë për inflacionin, pra ruajtjen e tij brenda intervalit 2 - 4 për qind. Inflacioni në fund të vitit



regjistroi shifrën 3.3 për qind, ndërsa në nivel mesatar vjetor ai ka qenë 2.37 për qind gjatë vitit 2003. Duke patur parasysh ndikimin e inflacionit në ekonominë shqiptare dhe arsyet që kanë mbështetur vendosjen e nivelit të objektivit të tij<sup>2</sup>, dëshiroj të ritheksoj se niveli i inflacionit ka qenë një kontribut pozitiv në zhvillimin e ekonomisë shqiptare, në ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë dhe në zhvillimin e sistemit bankar.

Grafik . Ecuria e inflacionit gjatë vitit 2003.



Çmimet e konsumit janë ndikuar nga një sërë faktorësh gjatë vitit 2003. Jo të gjithë këta faktorë janë nën ndikimin apo kontrollin e Bankës së Shqipërisë. **Inflacioni i lartë<sup>3</sup> në vendet tona kryesore partnere, Itali dhe Greqi, ka dhënë ndikimin e tij në rritjen e çmimeve të mallrave të importuara.** Struktura e shportës së indeksit të çmimeve të konsumit përfshin në mënyrë të konsiderueshme mallra të importit<sup>4</sup>, duke e bërë nivelin e çmimeve në vend të ndjeshëm ndaj inflacionit të vendeve partnere. Gjithashtu, **rritja e çmimeve të administruara të ujit në muajin shkurt, të energjisë në muajin maj dhe të telefonisë fikse në muajin dhjetor, kanë ndikuar në rritjen direkte të çmimeve të konsumit.** **Megjithë këto goditje, inflacioni ka rezultuar i ulët, duke reflektuar kontrollin e presioneve të kërkesës së brendshme si pasojë e respektimit të frymës së hartimit të politikave fiskale e monetare dhe objektivave të tyre.**

**Politika fiskale.** Pa dashur të ndalem në diskutimin e performancës së treguesve të detajuar fiskalë, dëshiroj të theksoj ndikimin pozitiv që kanë patur këta tregues në inflacion. Ky ndikim është shprehur në shpërndarjen më të njëtrajtshme të shpenzimeve buxhetore dhe të kërkesave të qeverisë për huamarrje gjatë vitit 2003, duke shmangur përqendrimin e tyre në tremujorin e fundit. Zgjedhjet lokale të tetorit dhe klima e acaruar politike gjatë gjysmës së dytë të vitit nuk janë shoqëruar me përqendrime të shpenzimeve buxhetore apo me kompromentim të

<sup>2</sup> Këto arsye janë zbërthyer më në hollësi në "Planin e Zhvillimit Afatmesëm të Bankës së Shqipërisë (2003-2005)".


<sup>3</sup> Në krahasim me nivelet historike të këtij treguesi.

<sup>4</sup> Ekonomia shqiptare, si një ekonomi në rritje dhe me një bazë të vogël prodhuese, mbetet e orientuar drejt importit. Gjatë këtij nëntëmujori importi ishte rreth 4 herë më i lartë se eksporti.

disiplinës fiskale. Gjithashtu, qeveria ka respektuar kufizimin e huamarrjes së brendshme të qeverisë në nivelin 2.7 për qind të PBB-së, duke lehtësuar punën e Bankës së Shqipërisë në kontrollin e likuiditetit dhe normave të interesit.

**Politika monetare** gjatë vitit 2003, megjithëse ka patur tendencë zbutëse, ka qenë e kujdesshme në drejtim të presioneve inflacioniste që ka përcjellë në ekonomi. Normat reale të interesit, në terma pozitivë, kanë vazhduar të ruajnë interesin e publikut për të depozituar kursimet e tyre në sistemin bankar, duke ndihmuar në një situatë të qëndrueshme të likuiditetit dhe respektimin e parashikimeve të programit monetar.

Grafik. Ndryshimet vjetore të agregatëve monetarë M1 dhe M3 (në përqindje).




Gjithashtu, Banka e Shqipërisë vlerëson se **është rritur orientimi i pritjeve të publikut**, veçanërisht i segmenteve më të specializuara të tij si sistemi bankar, drejt një niveli inflacioni brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Pritjet e publikut formojnë një pjesë të rëndësishme të mekanizmit të përcaktimit të çmimeve në ekonomi. Nga analiza e vrojtimeve të ndryshme të sistemit bankar, vihet re se pritjet e tij kanë qenë për një inflacion të ulët. Kjo ka shpejtuar kohën e reagimit të sistemit bankar ndaj vendimeve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

\*  
\*       \*

**Në vijim, dëshiroj të ndalem pak më gjatë në politikën monetare të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2003.** Politika monetare lehtësuese është diktuar nga përmirësimi i ecurisë së inflacionit dhe parashikimet pozitive për të dhe rivendosja e përgjithshme e ekuilibrit në treguesit monetarë. Kjo politikë ka gjetur shprehjen e vet **në uljen e normës bazë të interesit në ekonomi**, duke synuar uljen ekostos së parasë dhe nxitjen e kreditimit të ekonomisë. Banka e Shqipërisë ka ulur normën bazë të interesit në muajt prill, korrik, tetor dhe dhjetor. Në të

gjitha rastet, ulja e normës bazë të interesit ka qenë me 0.5 pikë përqindjeje, për një efekt total prej 2 pikësh përqindjeje. Kjo ulje, jo vetëm që ka eliminuar tërësisht rritjen me 1.5 pikë përqindjeje të normës bazë të interesit gjatë vitit 2002, por e ka sjellë nivelin e saj në minimumin historik gjatë tre viteve të fundit.

Grafik 13: Norma bazë e interesit në ekonomi.



**Në përputhje me politikën monetare zbutëse, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme edhe në tregun valutor** për të penguar mbiçmimin e lekut dhe për të injektuar likuiditet në treg. Tendencat mbiçmuese janë kushtëzuar nga diferenca e normave të interesit lek-valutë, e cila ka ndikuar në ruajtjen e një kërkese më të lartë për aktivet financiare në lekë krahasuar me ato në valutë, dhe nga nga rritja e ofertës së valutës krahasuar me atë të lekut gjatë kësaj periudhe. Me anë të blerjeve në tregun valutor, Banka e Shqipërisë ka tërhequr ofertën e tepërt valutore duke injektuar likuiditet në sistem.

**Politikës monetare lehtësuese i kanë shërbyer edhe rishikimi i disa instrumentave të politikës monetare,** të cilat janë përshtatur më mirë me realitetet e reja të tregut bankar shqiptar dhe janë përafuar me standartet e bankave qendrore më të zhvilluara. Këto ndryshime kanë synuar kryesisht uljen e kostos së ndërmjetësimit të sistemit bankar dhe nxitjen e aktivitetit në tregun ndërbankar.

E ndërgjegjshme për faktin që realiteti i ekonomisë shqiptare, duke përfshirë strukturën e ekonomisë, nivelin e konkurrencës dhe shumë aspekte të sjelljes konsumatore, janë larg parametrave normale, Banka e Shqipërisë nuk ka hezitur të ndërmarrë edhe fushata publike për zbutjen e këtyre fenomeneve. **Fushata për parandalimin dhe zbutjen e fenomenit të spekulimeve me çmimet** gjatë festave të fundvitit ka synuar pikërisht evidentimin dhe zbutjen e këtyre fenomeneve. Rezultatet e kësaj fushate, të faktuara jo vetëm nga pasqyrimi i konsiderueshëm në media, por edhe nga niveli i çmimeve në muajin dhjetor, kanë qenë të kënaqshme.

### **III.2. ZHVILLIMET E PRITSHME NË INFLACION GJATË VITIT 2004.**

Për vitin 2004 parashikimet tregojnë se norma e inflacionit do të luhatet mesatarisht në të njëjtat vlera të vitit të kaluar, brenda nivelit 2-4 për qind. Parashikimet për këtë ecuri inflacioni mbështeten në ruajtjen e prirjeve pozitive të vërejtura gjatë vitit 2003 në drejtim të konsolidimit të stabilitetit makro-ekonomik. Banka e Shqipërisë gjykon se përmbushja e treguesve të programuar makroekonomikë, veçanërisht kontrolli i shpenzimeve dhe financimit të brendshëm të deficitit buxhetor respektivisht brenda niveleve 29.3 dhe 2.8 për qind të PBB-së, do të jetë një bazë e qëndrueshme për garantimin e stabilitetit të çmimeve.

Nga ana tjetër, zhvillimet monetare gjatë vitit 2003 do të favorizojnë stabilitetin e çmimeve. Rritja e ofertës monetare në nivelin 10.6 për qind gjatë vitit 2004 do t'i korespondojë nevojave të ekonomisë dhe struktura e likuiditetit parashikohet e qëndrueshme. Gjithashtu, analiza e faktorëve bazë përcaktues të kursit të këmbimit sugjeron se luhatjet e këtij të fundit nuk do të përbëjnë kërcënim në drejtim të cënimit të objektivit të inflacionit.

Gjithsesi, çdo proces parashikimi përmban rreziqet e veta. Aq më tepër, këto rreziqe janë të pranishme në parashikimin e inflacionit, i cili varet nga një sërë faktorësh të paparashikueshëm. Nga lista e tyre do të dëshiroja të veçoja disa faktorë, të cilët mund të kushtëzojnë ndjeshëm ecurinë e inflacionit:

- **Ecuria e çmimeve të administruara.** Këtu kam parasysh ecurinë e çmimeve të energjisë elektrike dhe të telefonisë. Banka e Shqipërisë është njohur me ndryshimet e propozuara. Gjithsesi, shqetësimi i Bankës së Shqipërisë është inkuadrimi i këtyre rritjeve në strukturën e kostos së mallrave dhe, për më tepër, spekulimi me to, ashtu siç po tenton të vërehet aktualisht. Në këtë rast efekti i tyre në inflacion do të shfaqet i amplifikuar.
- **Ruajtja e reformave strukturore në sektorin e bujqësisë, në drejtim të rritjes së kapaciteteve prodhuese.** Inflacioni në Shqipëri është, në pjesën më të madhe, i lidhur me zhvillimet në grupin e mallrave ushqimore. Viti 2003 nxori në pah rritjen e kërkesës së ekonomisë në periudhën e verës si pasojë e rritjes së aktivitetit të turizmit. Prodhuesi dhe prodhimi shqiptar duhet të marrin një rol më aktiv në drejtim të përmbushjes së kësaj kërkesë dhe zëvendësimin e mallrave të importit.
- **Intensiteti i veprimit të faktorëve spekulativë, tashmë tradicionalë.** Fushata e Bankës së Shqipërisë për parandalimin e spekulimit me çmimet në festat e fundvitit rezultoi e suksesshme. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë është optimiste për reduktimin e


këtij fenomeni në të ardhmen. Gjithsesi, ai mbetet ende një ndryshore e panjohur në modelin e parashikimit të inflacionit.

**Sigurisht që është shumë shpejt të paraqesim shifrat e sakta të rritjes së inflacionit si pasojë e rritjes së çmimit të bukës dhe tarifave të energjisë elektrike, por Banka e Shqipërisë bazuar në të dhënat dhe llogaritjet paraprake, gjykon se këto efekte janë të pashmangshme dhe jo të neglizhueshme.**

#### IV. Zhvillimet kryesore monetare.


Në përgjigje të uljeve të normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë kanë reagur duke ulur normat e interesit të pranimit të depozitave, të bonove të thesarit dhe të kredidhënies në lekë. **Në mbështetje edhe të përmirësimit të situatës së likuiditetit në sistem, normat e interesit të kredive në lekë dhe të bonove të thesarit janë ulur më shumë se normat e interesit të depozitave në lekë, duke sjellë një ulje të koston totale të ndërmjetësimit të sistemit bankar gjatë vitit 2003.** Normat e interesit të depozitave me afat në lekë janë ulur me **1.9 pikë** përqindjeje, *yield*-i i bonove të thesarit me **3.1 pikë** përqindjeje ndërsa normat e interesit të kredive në lekë me **4 pikë** përqindjeje.

Grafik . Ecuria e normave të interesit.



Normat pozitive të interesit dhe diferenca e tyre me aktivet financiare në valutë, kanë ndikuar në mbiçmimin e lekut gjatë vitit 2003.

Grafik . Ecuria e kursit të këmbimit të lekut.



Përmirësimi i ambientit të përgjithshëm ekonomik, ulja e normave të interesit dhe situata e qëndrueshme e likuiditetit kanë bërë që kreditimi i ekonomisë të shënojë përmirësime të dukshme gjatë vitit 2003, duke mbështetur rritjen e ekonomisë në tërësi. **Kredia e re e akorduar gjatë njëmbëdhjetë muajve të parë të vitit 2003 ishte afërsisht 78 miliardë lekë ose 44 për qind më shumë se gjatë së njëjtës periudhë të vitit të kaluar.**

Ulja e normës bazë të interesit gjatë vitit 2003 nuk ka ndikuar negativisht në treguesit monetarë, duke mundësuar në përgjithësi ecurinë e këtyre treguesve sipas parashikimeve të programit monetar. Gjithashtu, ajo ka lejuar respektimin e objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë, nivelin dysHEME të rezervave ndërkombëtare neto dhe nivelin tavan të mjeteve të brendshme neto.

## V. Zhvillimet në sistemin bankar

Viti 2003 njohu hyrjen e dy bankave të reja në tregun bankar, duke çuar në 15-të numrin e bankave që operojnë në vend. Në fundviti 2003, përfundoi me sukses privatizimi i bankës më të madhe në sistem (Bankës së Kursimeve), dhe në treg operojnë 2 banka me kapital të përbashkët, një bankë me kapital privat vendas dhe 11 banka të tjera me kapital privat të huaj.

Sistemi bankar shënoi rritje të aktiveve të tij prej 40 miliardë lekë ose 11.8% nga fundviti 2002. Ndërsa burim i këtyre mjeteve janë kryesisht depozitat e pranuar nga publiku, procesi i investimit të tyre flet për mbrojtje ndaj rreziqeve të ndryshme që mund të ndeshet sistemi bankar. Në këtë mënyrë, evidentohet:

- Rritja e **rezervës së detyrueshme** pranë Bankës së Shqipërisë (rrjedhje e rritjes së depozitave).
- Rritja e **investimeve në bono thesari**, pavarësisht peshës së tyre në rënie ndaj totalit të aktiveve (nga 51.6% në fundvitin 2002, në 49.8% në fundvitin 2003), shkak i ritmit më të lartë rritës të këtyre të fundit.
- **Rritja e investimit në kredidhënie, nga 11.4% e totalit të aktiveve në fundvitin 2002, në 13.2%** për periudhën në fjalë. Vlen të përmendet rritja e huasë dhënë sektorit privat e individëve (nga 10.9% e totalit të aktiveve në 12.5% e totalit të aktiveve për fundvitin 2003), si dhe e huave afatmesme e afatgjata (edhe pse huaja afatshkurtër përbën 41.4% të totalit të kredidhënies).
- **Rritja e investimeve në “letra të tjera me vlerë” nga 4.9% e totalit të aktiveve në 5.5%** të tyre në fundvitin 2003. Në këtë periudhë evidentohen 7 banka të sistemit me një portofol të tillë, nga 3 banka në fundvitin e kaluar. Obligacionet dyvjeçare të Qeverisë Shqiptare luajnë rol të konsiderueshëm në zgjerimin e këtij portofoli.
- **Sistemi bankar evidentoi rezultat neto pozitiv prej 4.5 miliardë lekë, nga 3.9 miliardë lekë në fundvitin 2002.** Burimi kryesor i gjenerimit të të ardhurave janë “të ardhurat nga interesi”, ndërsa vlen të përmenden dhe “të ardhurat nga veprimtaritë e tjera.

Treguesit e efikasitetit shënojnë rritje nga një vit më parë:

-ROA llogaritet 1.4% nga 1.2% në fundvitin 2002,  
 -ROE rezulton 21.6% nga 19.1% në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Depozitat përbëjnë rreth 87% të fondeve të sistemit bankar. Krahasuar me fundvitin 2002 niveli i tyre shënoi rritje të konsiderueshme rreth 46 miliardë lekë. Kontributin më të lartë në rritjen e nivelit të depozitave të sistemit e dhanë bankat private, ndonëse Banka e Kursimeve vazhdon të ruajë nivelin më të lartë të depozitave në sistem.

Struktura e depozitave të sistemit evidentoi nivelin më të lartë të depozitave në lekë (69%), me afat (81%) dhe të pranuar nga individët (85%). Kapitali aksioner i sistemit shënon vlerën 24,3 miliardë lekë. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) në nivelin 33.5% vazhdon ta paraqesë sistemin të kapitalizuar. Rritja me ritme më të larta e aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut se ato të kapitalit rregullator do të shoqërohen me rënien e RMK dhe rritjen e eficiencës së bankave dhe sistemit. Pësia e Bankës së Kursimeve ndaj totalit të sistemit karakterizohet nga një rënie e ndjeshme gjatë viteve, për vetë faktin e rritjes së rëndësisë së bankave të tjera. Kjo ngjarje vlerësohet pozitive përse i përket efektit të përqendrimit të aktivitetit bankar, pasi ky i fundit konsiderohet “pengues” ndaj zhvillimit të konkurrencës së një sistemi.



Reduktimi i përqendrimit të aktivitetit bankar konkludohet dhe nga vlerat në rënie të indeksit H, sikurse tregohet në tabelën e mëposhtme:  
 Tab. 1. *Indeksi H<sup>5</sup> (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve.*

<b>Periudhat:</b>	<b>Dhjetor r 2000</b>	<b>Dhjetor 2001</b>	<b>Dhjetor 2002</b>	<b>Shtat or 2003</b>
<b>Indeksi i përqendrimit të aktiveve.</b>	<b>0.44</b>	<b>0.37</b>	<b>0.32</b>	<b>0.30</b>

Megjithatë, reduktimi i treguesit të mësipërm nuk mund të flasë për një konkurrencë të plotë të sistemit bankar. Ky i fundit (sistemi), edhe pse evidenton hapjen e degëve të reja (15 degë të reja gjatë vitit 2003), zgjerimin e gamës së produkteve dhe shërbimeve, përmirësimin e mjeteve të pagesës (kartat e kreditit, ATM-të, etj) ka ende për të udhëtuar në rrugën e arritjes së konkurrencës së plotë.

## **V.2. Banka e Kursimeve.**

Krijuar në Dhjetor 1992, Banka e Kursimeve është aktualisht banka më e madhe në Shqipëri. Ndërsa operon si një Bankë tregtare universale, përbëhet nga 36 degë të shtrira në të gjithë territorin e Shqipërisë. Investimet e saj janë kryesisht në Bono Thesari të Qeverisë së Shqipërisë dhe vendosje në depozita me bankat e huaja.

Për privatizimin e Bankës së Kursimeve, aksioneri i vjetër i kësaj Banke, Ministria e Financave, përgatiti një plan veprimesh për ristrukturimin e Bankës, për periudhën Dhjetor 2002 – Shtator 2003.

Në këtë plan ishte theksuar se “opsioni më i përshtatshëm për privatizimin e Bankës së Kursimeve ishte vazhdimi i këtij procesi i paraprirë nga një fazë e ristrukturimit intensiv me orientim kryesisht që merr në konsideratë çështjet kryesore të evidentuara nga investitorët strategjikë”.

Bazuar në sa më sipër ky plan konsistoi në:

- Zhvillimin e mëtejshëm të informatizimit dhe telekomunikacionit;
- Reduktimin dhe përmirësimin cilësor të stafit,
- Kalimin e shërbimeve fiskale,
- Ristrukturimin e rrjetit të Bankës,
- Përmirësimin e sistemit të pagesave,
- Shtrirjen rajonale të bankës,
- Reduktimin e dominancës së bankës
- Marketingun.

<sup>5</sup>  $H = \sum (\text{aktivet e një banke} / \text{totalit të aktiveve të sistemit bankar} * 100)^2$ .



Banka e Shqipërisë konstaton se menaxhimi i Bankës së Kursimeve sh.a ka realizuar plotësisht Planin e Masave për ristrukturimin e saj, plan i cili ka ndikuar në privatizimin e plotë të Bankës të realizuar së fundi.

Mbështetur në gjendjen financiare aktuale të Bankës së Kursimeve, ne vlerësojme pozitivisht përpjekjet e Këshillit Drejtues dhe të Menaxhimit të Lartë për një riorientim të Bankës drejt privatizimit të plotë të saj.

Në përfundim të procesit të sipërpërmendur, Banka e Kursimeve me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, u privatizua në 100 për qind të vlerës së aksioneve të saj në fund të vitit 2003.

Aktualisht pronari i ri i kësaj banke është Banka austriake Raiffeisen, e cila pritet që të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për vazhdimin e ristrukturimit të Bankës së Kursimeve, fakt ky që do të ndikojë në drejtim të përsosjes së infrastrukturës bankare në përgjithësi.

Ditët e fundit në Bankën e Shqipërisë ka ardhur kontrata e shitjes së 100 për qind të aksioneve të Bankës së Kursimeve bankës Raiffeisen, e cila shumë shpejt pas mendimit të specialistëve do të kalojë për miratim në Këshillin Mbikëqyrës.

Ndërkohë, pritet që Banka Raiffeisen të sjellë kërkesën për aprovim për aktivitetet në sistemin bankar shqiptar, kërkesë që do të diskutohet dhe miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë për t'i hapur rrugë aktivitetit të plotë të Bankës tashmë të privatizuar.

Gjatë vitit 2004 pritet të ndodhin ndryshime pozitive si pasojë e privatizimit të Bankës së Kursimeve të cilat pritet të japin efektin e tyre edhe në sistemin bankar dhe financiar.

## **V.2. Tendanca dhe perspektiva kryesore të sistemit bankar gjatë vitit 2004.**

- Përmirësimi i strukturës së investimeve të bankave sidomos në aktive më me risk (kryesisht në kredidhënie, mbi 15% të totalit të aktiveve) do të japë kontributin e vet në ekonomi;
- Rritja e të ardhurave të sistemit edhe nga aktivitetet e tjera krahas atyre nga interesat;


- Lehtësirat e ofruara për likuiditetin nga Banka e Shqipërisë do të kufizojnë ekspozimin e bankave të sistemit ndaj riskut të likuiditetit;
- Nivelet e mjaftueshme të kapitalit prezantojnë bankat të mbrojtura kryesisht nga risku i kredisë.

- Rritja e aktivitetit kreditues, kryesisht ndaj bizneseve të vogla.

- Normat e interesit në lekë dhe në valutë pritet të ndryshojnë në formë më të zbutur.
- Sektori i tregtisë do të vazhdojë të jetë sektori më i preferuar për kreditimin.
- Synohet forcimi i strukturave të kontrollit në banka lidhur me aktivitetin kreditues.
- Rritje e konkurrencës dhe shtrirje më e madhe e degëve në të gjithë vendin.
- Pritet shumë shpejt të aplikojë për licencë përfundimtare edhe një bankë tjetër private me kapital shqiptar.
- Do të përmirësohet drejt standardeve ndërkombëtare mbikëqyrja bankare e Bankës së Shqipërisë.

## **VI. Zhvillimet në rezervën valutore të BSH-së(raportimi) dhe në kursin e këmbimit.**

Gjatë vitit 2003 në tregun e brendshëm valutor kanë mbizotëruar prirjet mbicmuese të lekut. Faktor i rëndësishëm në forcimin e lekut kundrejt monedhave të tjera kanë qënë ndryshimi i ndjeshëm midis normave të interesit të ofruara nga investimet në monedhën vendase (depozita në lekë, bono thesari) kundrejt atyre në valutë, e gjithë kjo në kushtet e një inflacioni të ulët brenda kufijve të synuar nga Banka e Shqipërisë. Në dallim nga vitet e tjera u vu re se prirjet forcuese të lekut qenë të pranishme edhe gjatë pjesës së parë të vitit. Njëkohësisht, u vu re se dobësimi i ndjeshëm i dollarit amerikan në tregjet ndërkombëtare, monedhë kjo psikologjikisht e rëndësishme, nxiste volatilitet në tregun e brendshëm. Këta dy faktorë e nxitën Bankën e Shqipërisë të qe e pranishme në treg në gjysmën e parë të vitit, ku ndërhyrja qe në masën 40 milionë USD. Në vijim, konfirmimi i prirjeve forcuese të lekut solli një prani më të ulët të BSh, gjë që ndikoi në një mbicmim të lekut ndaj euros në pjesën e dytë të vitit si dhe në një luhatshmëri më të lartë të raportit EUR/Lek gjatë së njëjtës periudhë. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në gjysmën e dytë të vitit qenë të përqëndruara në periudhat kur leku tradicionalisht tenton të forcohet më shumë. Kështu gjatë muajit gusht u blenë rreth 6.4 milionë USD, ndërkohë që në dhjetor mungesa e agresivitetit të Bankës së Shqipërisë në treg (u blenë rreth 3.4 milionë USD) solli vlerat e të dy valutave kryesore, euro dhe dollar amerikan, në nivelet më të ulta për vitin 2003. Në përgjithësi, forcimi i lekut ka ndikuar pozitivisht në treguesin e inflacionit duke ndikuar në uljen e inflacionit të importuar, si dhe duke nxitur një besim më të madh në tregjet financiare vendase (ritja e pjesëmarrjes së individëve në ankandet e bonove të thesarit).



## Zhvillimet në rezervën valutore

Në fund të muajit dhjetor vlera e rezervave valutore bruto llogaritet në 1.0265 miliardë dollarë duke regjistruar kështu, vetëm gjatë vitit 2003, një rritje me **186.62 milionë dollarë ose rreth 22 për qind**.

Ndër faktorët që e kanë ndikuar pozitivisht rezervën bruto, me rreth 236.85 milionë dollarë, përmendim hyrjet nga:

- lëvrimi i huave të dhëna nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore dhe nga institucione financiare ndërkombëtare ( 68.05 milionë dollarë);
- veprimet e blerjes së valutës nga bankat e nivelit të dytë dhe nga Ministria e Financave (87.80 milionë dollarë);
- derdhje nga bankat e nivelit të dytë pranë Bankës së Shqipërisë për plotësimin e rezervës së detyrueshme (28.08 milionë dollarë);
- të ardhurat e siguruar nga investimi i rezervës valutore (28.95 milionë dollarë).

Blerjet me bankat e nivelit të dytë që lidhen me ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm valutor kanë kontribuar ndjeshëm në rritjen e rezervave valutore. Këto blerje të valutës, krahas atyre të realizuara me Ministrinë e Financave gjatë 2003, përbëjnë zërin kryesor ndër faktorët me ndikim pozitiv në vëllimin e rezervës valutore, ndërkohë që për 2002 si faktor kryesor në rritjen e rezervës vlerësohen hyrjet nga huatë e lëvruara nga institucione financiare ndërkombëtare.

Daljet nga rezerva valutore gjatë 2003 arrijnë në 127.23 milionë dollarë dhe përfaqësohen nga transfertat e kryera me urdher të Ministrisë së Financave dhe të bankave të nivelit të dyte si dhe nga kryerja e shërbimit të pagesës së borxhit të jashtëm për qeverinë shqiptare.

Duke qenë se rezervat valutore janë të vlerësuara në dollarë amerikanë mbicmimi i ndjeshëm i euros gjatë vitit 2003 në raport me dollarin amerikan, me rreth 20%, ka ndikuar në llogaritjen e një efekti pozitiv, 87 milionë dollarë, në rezervën bruto si pasojë e ndryshimit të kursit të këmbimit.

## **VII. Projektet e Bankës së Shqipërisë për vitin 2004:**

### **VII.1. Fushata kundër "cash" në ekonomi**

Fushata e iniciuar nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2003 rezultoi e frytshme dhe me efekte pozitive, veçanërisht në drejtim të sensibilizimit të përgjithshëm për nevojën dhe mundësitë për reduktimin e cash-it. Më të rëndësishëm mund të konsiderojmë nxitjen e institucioneve për të ndërmarrë masa dhe hapa konkrete dhe përfshirjen e trajtimit të kësaj çështjeje në programet dhe planet e tyre.

Ministria e Financave ka përfshirë tashmë si një objektiv të saj për vitin 2004, liberalizimin e llogarive dhe shërbimit të buxhetit në të gjitha bankat e nivelit të dytë brenda tremujorit të parë '04 dhe kalimin e pagave në llogari, për të paktën 10% të punonjësve shtetërorë brenda shtatorit 2004. Banka e Shqipërisë po bashkëpunon me bankat e nivelit të dytë për të qënë të gatshme të presin këta klientë të rinj dhe të ofrojnë një shërbim cilësor dhe me përfitime të dyanshme.

Është përfshirë në paketën e re fiskale detyrimi që çdo biznes duhet të ketë llogari bankare dhe çdo pagesë mbi 500 mijë lekë të kryhet në bankë.

Ministria e Ekonomisë ka programuar një numër aktivitete në rajone të ndryshme të Shqipërisë për edukimin e komunitetit të biznesit për avantazhet e zëvendësimit të cash-it.

Një pjesë e mirë e bankave kanë përshpejtuar investimet në pajisje e rrjete ATM dhe kanë shtuar fushatën publicitare për shërbime bankare dhe oferta atraktive të pagesave jocash. Mjaft pozitiv është bashkëpunimi midis KESH apo Albtelecom me bankat për mundësimin e pagesës direkte të faturave në bankë.

Banka e Shqipërisë së bashku me institucionet partnere do ta vazhdojë intensivisht luftën ndaj cash-it edhe gjatë vitit 2004, duke mbështetur

iniciativat e institucioneve partnere por edhe duke investuar në ndërtimin e një sistemi pagesash efektiv modern dhe në përputhje me standartet europiane.

## **VII.2. Integrimi evropian**

Integrimi evropian është objektivi strategjik i shtetit shqiptar, që me diskutimet për nënshkrimin e marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian do të shndërrohet në një marrëveshje kontratë me detyra dhe objektiva të sakta, që do të respektohen nga çdo institucion shqiptar.

Dihet se objektivi kryesor i bashkimit të shteteve të Evropës në një komunitet është “krijimi i një tregu të përbashkët, si dhe një bashkimi monetar dhe ekonomik .. që synon nxitjen e zhvillimit të harmonizuar, të balancuar dhe të qëndrueshëm ekonomik, nivel të lartë punësimi dhe mbrojtje sociale, rritje të qëndrueshme joinflacioniste... etj”. Nuk dua të zgjatem këtu duke komentuar këto objektiva të Bashkimit Evropian të përcaktuara në Traktatet e ndryshme, por dua të theksoj se detyrat e ligjshme të Bankës së Shqipërisë kërkojnë angazhimin maksimal të institucionit tonë në këtë proces të vështirë dhe të gjatë të integrimit.

Që në muajin janar të këtij viti, ne treguam disa nga synimet tona që do të përmbliidhen në një strategji të veçantë të Bankës së Shqipërisë për integrimin evropian.

E para dhe më e rëndësishmja është liberalizimi i lëvizjeve të kapitalit. Ky është një proces i gjatë, i domosdoshëm dhe shumë i rëndësishëm. Aktet tona nënligjore për veprimtarinë valutore janë përmirësuar duke reflektuar fazat më të larta të zhvillimit dhe do të vazhdojnë të plotësohen e të rishqyrtohen. Vetë procesi i integrimit presupozon lëvizjen e lirë të kapitalit, prandaj ky proces kondiderohet i domosdoshëm. Ndërkohë mobilizimi i kapitalit të huaj në formën e investimeve direkte dhe formave të tjera ndikon dukshëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Për liberalizimin e llogarisë kapitale do të përpilohet një matricë veprimesh, institucionesh bashkëpunuese, përgjegjësish dhe natyrisht, ndërgjegjësimi të publikut dhe bizneseve.

Së dyti, nuk mund të kuptohet lëvizja e lirë e kapitalit pa forcimin e sistemit bankar, pra pa zhvillimin e mbikëqyrjes bankare. Ky aktivitet i Bankës së Shqipërisë është në fazën e zhvillimit të mëtejshëm duke u mbështetur edhe nga një projekt i Bankës Botërore. Forcimi i mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë dhe konsolidimi e zhvillimi i sistemit financiar, do të japin kontributin e tyre edhe në luftën për parandalimin e pastrimit të parasë.

Së treti, përfundimi dhe përsosja e projekteve për sistemet e pagesave.

Së katërti, rritja e besimit të publikut dhe bizneseve në aktivitetin e Bankës së Shqipërisë dhe të sistemit bankar do të realizohen nëpërmjet rritjes së vazhdueshme të transparencës që karakterizon aktivitetin e saj, si dhe do të punohet për edukimin e mëtejshëm të publikut duke u mbështetur edhe në bashkëpunimin tradicional dhe të thelluar me median.

### **VII.3. Fillimi i projektit të Pagesave të Menjëhershme Ndërbankare.**

Banka e Shqipërisë përfundoi me sukses projektin e sistemit ndërbankar të pagesave me vlerë të madhe (AIPS) dhe tashmë njofton të gjithë aktoret e sistemit për fillimin së shpejti të zbatimit të këtij projekti.

Vënia në funksionim e këtij sistemi është një ndër hapat kryesore të Bankës së Shqipërisë në thellimin e reformave financiare në Shqipëri, në forcimin e stabilitetit dhe rritjen e efikasitetit të sektorit financiar dhe atij bankar në veçanti.

Sistemi AIPS është mbështetur në standartet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, kontribut kryesor i të cilit pritet që të jetë zgjerimi cilësor i kapaciteteve operacionale për një shkëmbim eficient dhe të sigurtë të vlerave monetare. Ky zgjerim nga ana e tij do të sjellë rritjen e besueshmërisë të përdoruesve vendas dhe të huaj tek kapacitetet dhe qëndrueshmëria e sistemit bankar shqiptar.

Vënia në funksionim e këtij sistemi nënkupton uljen e kostos së lartë operacionale dhe shkurtimeve të kohës së përpunimit të instrumentave të pagesës.

#### **Më konkretisht sistemi i ri do të garantojë:**

- ❖ Shlyerjen e menjëherëshme, në pak sekonda, të pagesave ndërbankare;
- ❖ Krijimin e lehtësirave në rritjen e efikasitetit të administrimit të përditshëm të likuiditetit nga ana e vetë bankave;
- ❖ Uljen e riskut në sistemin bankar;
- ❖ Krijimin e një infrastrukture të shëndoshë, për ngritjen e një sistemi tjetër po kaq të rëndësishëm atij për kryerjen e pagesave me vlerë të vogël të popullatës.
- ❖ Krijimin e një infrastrukture të shëndoshë, për inkurajimin e mëtejshëm të zhvillimeve të tregjeve financiare duke mundësuar një transmetim më efikas të politikës monetare.

Sistemi i ri AIPS do të shtrijë aktivitetin e tij dhe në ekzekutimin e pagesave në vlerë të madhe të bizneseve dhe të individëve, duke sjellë uljen e kohës së ekzekutimit. Pra, pritet që ndikimi i sistemit të ri të jetë i

ndjeshëm dhe i pranishëm edhe jashtë sistemit bankar, në përgjithësi tek të gjithë agjentët ekonomike që shlyerjen e detyrimeve të tyre financiare e realizojnë nëpërmjet sistemit bankar.

Sistemi AIPS ndonëse administrohet nga Banka e Shqipërisë, është në thelb një shërbim i ri që ju ofrohet gjithë sistemit bankar. Banka e Shqipërisë, në operimin e këtij sistemi do të zbatojë një politike transparente, barazie dhe gjithë-përfshirëse ndaj bankave, duke kërkuar prej tyre njëkohësisht shkallë të lartë angazhimi dhe bashkëpunimi.

Në përfundim, Banka e Shqipërisë përfiton nga rasti për të shprehur falenderimet e saj bankave tregtare, anëtare të sistemit AIPS si dhe Bankën Botërore si një nga bashkëfinancuesit dhe mbështetësit për ngritjen e këtij sistemi.

**Ju Faleminderit!**